



Pranuar / Përmirësimi Me 16-03-2026			
Nr. Komand Org. Breg	Nr. Breg	Shitja e Tërbat	Vlera Vlerësi
02-118/02336			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë
Opština Vitina – Municipality of Vitina



Viti, 16 mars 2026

THIRRJE PUBLIKE
për
mbështetje financiare të entiteteve publike sipas rregullores
MF-NR-04-2017

1. Të gjitha organizatat jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Vitisë, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Vitisë, programi i punës i të cilave bazohet në programin e punës së DKRS-së në Viti të aplikojnë për mbështetje financiare në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit:

Në fushën e kulturës:

- Promovimi dhe afirmimi i vlerave kulturore.
- Promovojnë krijimtarinë lokale artistike;
- Promovojnë diversitetin lokal kulturor dhe nxisin dialogun artistik ndërkulturor;
- Promovojnë trashëgiminë kulturore;
- Kontribuojnë në shtrirjen e kalendarit kulturor përgjatë tërë vitit duke u fokusuar në festat zyrtare
- Kontribuojnë në zhvillimin e turizmit kulturor lokal;
- Nxisin pjesëmarrjen e audiencave të reja në jetën kulturore;
- Festalet, koncertet, shënimet e datave historike - kulturore, simpoziumet dhe ekspozitat.
- Grupet/shoqëritë kulturore-artistike që funksionojnë në Komunën e Vitisë, mbështeten bazuar në realizimin e suksesshëm të tyre kulturore dhe artistike në vitet paraprake.

Në fushën e rinisë

- Fuqizimi i rinisë
- Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rinore në zhvillimin e aktiviteteve specifike për të rinjtë që ndikojnë drejt për së drejti në nxitjen e aktiviteteve në fushat e ndryshme të përfshirë në Strategjinë Kosovare për Rini dhe Plan të Veprimit
- Mbështetja për përfshirjen sociale dhe organizimi i ngjarjeve provuese dhe rekreative.
- Mbështetja të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik

Në fushën e sportit

- Zhvillimi i sportit në Komunën e Vitisë
- Masivizimi i sportit për të rinj,
- Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive
- Organizimi i aktiviteteve sportive
- Projektet të ndryshme me grup-mosha të ndryshme,
- Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive,
- Aktivitete edukative me simpatizantë me qëllim kultivimin e vlerave fisnike të sportit,

2. Komuna e Vitisë do ta formoje një komision profesional për vlersimin e projekteve dhe rezultatet do të jenë publike për secilen OJQ aplikuese të detajuara sipas rregullores MF-NR-04-2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

▪ **Vlerësimi do të bëhet sipas:**

1. Plotësimi të kushteve administrative të aplikimit;
2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes;
3. Kapacitetit të dëshmuar organizativ dhe menaxhues;
4. Vazhdimësisë së realizimit të programit dhe qëndrueshmërisë së tij;
5. Njohjes ose kontributit për afirmimin ndërkombëtar të qytetit të Vitisë;
6. Planit dhe objektivave të DKRS-së
7. Origjinalitetit të projektit.

2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë:

- Formulari i Aplikacionit për projekt/programit **F-9** (word e shtypur);
- Formulari i Propozim buxhetit **F-10** (format Excel e shtypur);
- Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë **F-11** (format word e shtypur);
- Formulari i deklaratës së partneritetit **F-12** (format word e shtypur);
- Forma e deklaratës së projekteve të financuara **F-13** (format word e shtypur);
- Deklarata e përbashkët **F-14** (format word e shtypur)
- Dokumenti identifikues (**fotokopje e shtypur**);
- Certifikata e regjistrimit OJQ dhe Numri Fiskal (**fotokopje e shtypur**);
- Konfirmim nga banka për **xhirollogarinë** e aplikuesit.
- Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha **detyrimeve tatimore** ndaj ATK-së;
- Dëshmi të implementimit të projekteve/programëve të ngjashme
- **CV-ja** e menaxherit të projektit (word);

3. Formulari për aplikim mund të merret në ueb-faqe të Komunës apo në zyrat e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe mund të dorëzohen duke filluar nga data **16 Mars – 6 Prill 2026 ora 15:00 (15 ditë pune)**. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Kriteret:

1. OJQ-të në kuadër të kësaj thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti një projekt dhe në njërën nga fushat e thirrjes publike.
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në Komunën e Vitisë (Veprimtaria e tyre në komunën e Vitisë të jetë e dëshmuar para publikimit të kësaj thirrje).
3. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në njërën nga fushat e aplikimit dhe nuk do të mirren parasysh aplikimet jashtë fushave të kësaj thirrje publike.
4. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Vitisë - Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
5. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Vitisë.
6. **Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dhe CD duhet të dorëzohen te Zyra e protokollit (Arkivi) Nr.1 në ndërtesën e re të Komunës së Vitisë**
Për: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
7. Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
8. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
9. Një përfitues lejohet të përfitojë me vetëm një OJQ në të gjitha fushat e kësaj thirrje publike.

Vërejtje:

Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kritereve të thirrjes publike nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e Projekt projekt-propozimeve.

Organizatave të cilat nuk i kanë përmbyll projektet e vitit paraprak me Raporte Financiare dhe Narrative nuk do të mbështeten financiarisht, OJQ-të duhet ta dëshmojnë dorëzimin e raporteve narrative dhe financiare nga viti paraprak të protokoluara dhe dorëzuara tek komisioni i monitorimit të projekteve.

Për çdo informatë dhe për të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: dkrs.subvencionet@gmail.com , lsmet.sejdiu@rks-gov.net

Kryetari i Komunës z. Sokol HALITI

